

Zanat e malit dhe fugja e Mujit



BOTIMET
TOENA
TIRANE

ODHISE K. GRILLO

Zana e malit

dhe

fuqia e Mujit

Ilustrimet nga:
VEHAP KOKALARI

CITTA' di CHIERI
CONSIGLIERE COMUNALE
Vincenzo Cucci

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2000






Në Klladushë të Jutbinës na paska jetuar një baba që kishte dy djem e një vajzë. Të bijtë quheshin: njëri Mujë e tjetri Halil, ndërsa çika Kunje. Ishin njëri më i mirë e më punëtor se tjetri, njëra më e bukur se të tjerët, se u kishin ngjarë tatës e mëmës, si në pamje ashtu edhe në punë.

Me që ishin të varfër e të këputur, sa hodhi pak shtat e sa mbushi dhjetë-dymbëdhjetë vjet, i ati e futi Mujin lopçar te një pasanik vetëm e vetëm për bukën e gojës e për asgjë tjetër. As për rrobe e as për opinga.



I vinte përpara lopët Muji çdo ditë, sapo dilte në qiel ylli i mëngjesit, dhe ngjitej për t'i kullotur bjeshkëve ku bari rritej gjer mbi gju... Pastaj kthehej në mbrëmje vonë në shtëpinë e pasunarit, kur qelli pikëzohej nga mijëra yje.



Edhe pse hante pak bukë tē thatë me një grusht kripë e asgjë tjetër, Muji ishte i shkathët e punëtor, prandaj i conte lopët sa nga një livadh në tjetrin, sa nga një luginë në tjetrën e sa nga një bjeshkë në tjetrën. I kulloste për shtatë palë qejfe dhe u jepte ujë nga gurra që buronte ujë si akull. Me atë ujë shtynte poshtë edhe bukën e thatë që hante.

Lopët hanin majën e barit dhe kur vareshin poshtë për në fshat gjintë e tyre preknin tokën, aq shumë mbusheshin me qumësh tē ëmbël, që vinte era mjaltë e trëndelinë.

Kur i milnin lopët në vathë, pasunari çuditej e i bënte sytë sa një filxhan, se shikonte vedrat e kovat që mbusheshin grykë më grykë dhe qumështi s'kishte tē sosur. Kështu, pas pak ditëve, zotëria bleu edhe plot vedra e kova tē tjera, po një fjalë tē mirë e pak më shumë bukë nuk i dha Mujit asnjëherë.



Kaluan kështu ditë, javë e muaj dhe erdhi një ditë e hidhur si pelini, që Mujit i humbën lopët nga sytë dhe kushedi nga u fshehën luginave. Kérko andej e kérko këndeje, kérko në bjeshkë e kérko në vërrri, lopët nuk u gjetën dot. Ku të vente e ku të futej? A mund të kthehej te zotëria pa lopët? Ai edhe mund ta vriste, se për pasuri e pare vriste edhe fëmijët e vet...




Si të bëj e si të mos bëj, Muji e djerrasiti mendjen dhe e vendosi të mos kthehej, se nuk donte të dëgjonte e të gëlltiste shpotitë e sharjet e shokëve dhe fjalët e ndyra e poshtëruese të pasanikut, dajakun e tij, e, ruajna Zot, edhe ndonjë kokërr plumbi prapa krahëve...



Me që kishte rënë mbrëmja edhe hënë e yje nuk kishte asnë pér be, që tē ndriçonin vendin e tē mund tē vazhdonte kërkimin e lopëve, Muji u shtri rrëzë një shkëmbi dhe, ca nga lodhja e madhe e ca nga halli që e kishte zënë, e mori gjumi.

Sa pa myllur mirë sytë diku aty afër u dëgjua e qara e dy fëmijëve. Muji u ngrit dhe shikoi rrëtherrotull e së fundi pa dy djepe, në tē cilët ishin mbuluar e lidhur me shpërgënje dy vogëlushë, që qanin me tē madhe. U mundua t'i pajtonte me ledhatime e fjalë tē ngrohta, po më kot. Ata nuk pushonin. Atëhere hyri në mes tē djepeve, duke u kënduar një ninullë. Tund djetet e këndo ninullën, tund djetet e këndo ninullën vocërrakët i kaploj gjumi...



Aty nga mezi i natës Mujit iu afroan dy hëna që nuk ishin hëna, po Zana të Malit. Veshjet e tyre ngjanin si të ishin prej ari dhe lëshonin rreze të larueshme. Ato ngjanin më të bukura se hëna vetë.



Zanat e kishin parë Mujin duke tundur djepet e duke kënduar ninullën dhe e pyetën:

- Kush je ti e çfarë kërkon këtu?



- Unë jam Muji, një lopçar i varfër që ruaj lopët e zotërisë. Bredh bjeshkëve me to nga agimi në mbrëmje dhe i kullot si s'ka më mirë, po ç'e do se sonte më humbën... I kërkova kudo po s'i gjeta dot. Me që u lodha e u rraskapita duke bredhur lart e poshtë, dhe me që nata s'kishte as hënë e as yje, u shtriva rrëzë këtij shkëmbi të marr një sy gjumë e të shplodh kockat. Sa pa mbyllur sytë mirë dëgjova të qara çiliminjsh. U zgjova, i gjeta vocërrakët në djepe duke u lebetitur dhe më erdhi keq si për vëllanë tim të vogël, Halilin. Nisa t'i tund e t'u këndoja një ninullë dhe ata fjetën si qengja, siç e shikon edhe vetë. Kaq kisha unë. Tani më tregoni edhe ju cilat jeni e nga vini...



- Ne të njohim, o Mujë, - i thanë dy shtojzotvallet, -se të kemi parë sa e sa herë këtyre anëve. Jemi Zana mali dhe gjithmonë dalim natën për të ndihmuar nevojtarët e skamorët. Me që na pajtovë fëmijët, me që i vure në gjumë dhe me që je njeri i mirë, punëtor e i dashur, ne duam të të ndihmojmë. Kërkona çfarë të të dojë e bardha zemër se kemi fuqi të të japid cdo gjë e të bëjmë gjithçka. A pranon?

- Ju faleminderit, moj Zana të bukura e shpirtmëdha, po unë as bëra gjë e as dua gjë...

- Hape gojën e folë, o Mujë, se bëre shumë për ne e për fëmijët tanë.

- Siç e shihni, unë jam pak i dobët e i thatë dhe vërsnikët më tallin e më vënë me shpatulla përtokë. A mund të më dhuron i pak fuqi, që t'i mund?



- Në çast, - ia kthyen Zanat. – Eja e pi qumësht në gjintjtë tanë dhe do të bëhesh kreshnik e do të mundësh edhe egërsirat edhe divat.

Muji piu tri pika dhe ndjeu se u forcua përnjëherësh.

- Tani ngrije atë shkrepin, që të shohim sa i fortë u bëre, - i thanë Zanat.

Muji e ngriti gjer te kocet e këmbëve shkrepin e jo më lart dhe e lëshoi përtokë.



- Ne te niohim, o Muji - i thanë dy shkrepotvallet - se të kemi
- Pi përsëri, që të bëhesh edhe më i fortë, - i thanë Zanat.

Muji piu tri pika të tjera dhe iu duk se u forcua më shumë.
Zanat i thanë ta ngrinte përsëri shkrepin. Muji e ngriti gjer te gjunjët
e jo më lart dhe e lëshoi prapë në tokë.

Pastaj i dhanë prapë gji dhe Muji e ngriti shkrepin gjer në brez
e jo më lart.

Pastaj i dhanë prapë gji dhe Muji e ngriti shkrepin përmbi supe,
duke e mbajtur fort me të dy duart e duke mos lëvizur nga vendi
fare.

- Tani je bërë më i fortë se vetë shkrepni, o Mujë, - i thanë Zanat.
- Ashtu është, o motrat e mia, - tha Muji. - A doni ta vërtit gjer
në det?



jū a nolit mën
mështëse vërtet
të përgjigjet
o që dëshirat
që
- Atëherë s'duhet tē pish më qumësht se pastaj mund tē bësh
dëme tē mëdha atje ku do ta flakësh. Mirë?

Muji tundi kokën nga poshtë - lart e nga lart – poshtë dhe tha
vetëm dy fjalë:

- Me forcën që më dha tambli (ne themi qumështi...) e mund
cilindo!



Zanat e pyetën për gjithçka dhe Muji u tregoi për familjen e tij e për fshatin, për krahinën e për gjithë vendin. Ndërkokë errësira po davaritej, zogjtë nisën t'ia thonë këngës, u dëgjuan zilet e këmborët e bagëtive, burimet e lumenjtë ligjëronin dhe zefiri i bjeshkës po frynteë ëmbël-ëmbël...

- Po sikur të të bëjmë byrazer, apo vëllamë si i themi ndryshe, a pranon?

- Pranoj, si nuk pranoj, se do të jem më i lumturi i botës. Kur të kem nevojë do t'u kërkoj ndihmë e kur të keni nevojë ju do t'u gjendem pranë. Mjafton të më thërrisni.

- Qoftë e bërë, o vëllamë, - i thanë Zanat dhe shtrënguan duart.

Kur ra mëngjesi Zanat morën djepet nën sjetull dhe u zhdukën e u bënë mjegull saora, si të ishin xixëllonja. Muji fërkoi sytë pasi kujtoi se ishte në ëndërr, po ja që çdo gjë ishte e vërtetë si drita e diellit, se ai e provoi në çast me duart e tij: mori e çoi mbi krye një shkrep shumë më të madh se atë që ngriti pasi piu qumësht në gjirin e Zanave.



Pastaj, hidh një hap në këtë kodër e hidh një hap në kodrën tjetër, bjeshkë më bjeshkë e vërr i më vërr, i gjeti lopët për pesë dekika dhe u gëzua si fëmijë, kështu zbriti në fushë duke vënë lopët përpara. Aty ishin mbledhur barinjtë versnikë dhe sa e panë nisën ta tallin e ta vënë në lojë, po Muji nuk u ktheu fare përgjigje. Veç u tha:

- A dëshiron ndonjë prej jush të kapet me mua?
- Pa folur fare iu afrua lopçari më i fortë se gjithë shokët:
- Dua unë të matem unë me ty, - i tha.

Dhe u kapën. Muji e mbërtheu fort për beli, e ngriti me një dorë gjer te degët e çinarit që kishin mbi krye e që u bënte hije dhe pastaj e vuri me shpatulla përtokë.



- A do të matet edhe ndonjë tjeter? – i pyeti.

Lopçarët e vegjël s'pipëtitën fare, po vunë këmbët e lepurit dhe sakaq u zhdukën lugjeve e përrrenjve.

Muji vuri përpara lopët, zbriti te shtëpia e zotërisë dhe i tha:

- Që sot e tutje merr një lopçar tjeter për të të ruajtur lopët, se unë do të kthehem në shtëpinë time dhe do të punoj për vete, për familjen, për fshatin e krahanët dhe për gjithë vendin tim.

Dhe shkoi në Jutbinë ku kishte nënën e babën, motrën e vëllanë. Si u çmall me ta, doli pyjeve e zhduku gjithë egërsirat. Pa doli në kufi përmbi bjeshkë dhe u tregoi ku e kishin kufirin krajlat e Serbisë e të Malit të Zi...
e bagetive, burlimet e huazimit, ujorenin që zbulonin
fryntë embel-embel...



LEGJENDA SHQIPTARE - 12

libra të ilustruar për fëmijë

ZANAT E MALIT DHE FUQIA E MUJIT

Autor: Odhise Grillo

Piktor: Vehap Kokalari

Përkujdesja grafike: Irena Toçi

Janë në qarkullim nga e njëjta kolanë:

SKËNDERBEU

BESA E SHQIPTARIT

DY BATOT DHE ZANA E ILIRISË

TRIM MBI TRIMA, GJERGJ ELEZ ALIA!

MARO KONDA, TRIMËRESHË!

PRITE, PRITE AZEM GALICËN!

KAPEDAN ÇELO PICARI

LEGJENDA E NJË SHKËMBI

OSO KUKA NË KULLË T'BAROTIT

KOSTANDINI DHE DHOQINA

ZANAT E MALIT DHE FUQIA E MUJIT

KALAJA E ROZAFATIT

NËNA ME ZEMËR TË MADHE

BOTIMET TOENA

ISBN 99927 1 256 2